



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	03 - 08	3	viti год year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHK	5504/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.922/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.922/2023, të datës 06.07.2023 të ankuesit Bejtush Fetija të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted] me adresë rruga [redacted] Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.01/2023 të datës 07.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.922/2023 e datës 06.07.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.01/2023 i datës 07.06.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 06.04.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Referencës: RN0011410 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Proklitike respektivisht për pozitën Zyrtar i Misionit Diplomatik, ku afati për aplikim ka qenë nga data 27.04.2023 deri më datë 06.05.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Vendimit me Nr.09/2023 të datës

30.05.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi të kopjes së diplomës respektivisht nostrifikim për diplomat e marra jashtë vendit po ashtu nuk ka bashkangjitur dëshminë e punësimit.

Kundër këtij vendimi, ankuesi ka parashtruar ankesë, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme me Vendimin me Nr. 01/2023 të datës 07.06.2023 ka aprovuar pjesërisht ankesën e ankuesit duke e marr për bazë pretendimin e ankuesit sa i përket aspektit se ende nuk e ka marr vendimin përfundimtar për nostrifikim edhe pse ka aplikuar ndërsa nuk e ka përfshirë në listën e ngushtë për shkak që nuk ka ofruar dëshmi të punësimit.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.01/2023 të datës 07.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 06.07.2023 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 5035/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 14.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa Këshilli me datë 17.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.07.2023 me numër protokolli 5035/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Konkursin me Nr.Referencës: RN0011410 për grupin Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Proklitike respektivisht për pozitën *Zyrtar i Misionit Diplomatik*; Vendimin me Nr. 09/2023 të datës 30.05.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Ankesën e ankuesit; Vendimin me Nr. 01/2023 të datës 07.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Njoftimin e datës 30.06.2023; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti për periudhën 01.08.2002 deri 25.04.2023; Autorizimin e datës 04.07.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 17.07.2023; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Aplikacionin e ankuesit i datës 02.05.2023; Diplomë e datës 30.04.2017; Certifikatën të studimeve shtator 2019; Dokument identifikimi i ankuesit; Certifikatën Shëndetësorë e datës 26.04.2023; Vërtetimin e datës 26.04.2023 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Komunën e Kamenicës; Certifikatën mbi dënimet penale e datës 26.04.2023; Njoftimin nga NARIK Kosova i datës 03.05.2023 për ankuesin; Njoftimin e datës 30.05.2023. 07.06.2023; Vendimin me Nr. 05/1142 të datës 10.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, kundër Vendimit me Nr.01/2023 të datës 07.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pretendon se ky vendim është i kundërligjshëm për shkak që nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që pasqyra e pagesave në fondin për kursime pensionale është një dokument i cili gjen zbatim në çdo procedurë të rekrutimit dhe i cili dëshmon për periudhën e punësimit duke përmbajtur të gjitha të dhënat si punëdhënësin, datën apo periudhën kohore të punësimit; Si rezultat i kësaj më janë mohuar të drejtët e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit, konstaton së në konkursin Nr.Referencës: RN0011410 për grupin "Specialist i Përgjithshëm të Shkencave Proklitike respektivisht për pozitën *Zyrtar i Misionit Diplomatik*, kriteret e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në Shkenca Politike/ Administratë Publikë/ Politika Sociale/ Juridike.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Njohja e gjuhës GJERMANE në nivelin C1-C2 (e obliguar). Ndihja e gjuhës Gjermane dëshmohet përmes certifikimit në një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë;*
- *Përvoja e punës: Se paku një (1) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimi për diplomat e marra jashtë vendit; Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve; Kopjet e dëshmive së njohjes së gjuhës GJERMANE... Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar; Certifikatë/vërteti nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojë e kërkuar e punës,. Është ne sektorit publik atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë/*

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit po ashtu edhe në shqyrtim të të gjitha shkresave të lëndës, konstaton se përfshirja në listën e ngushtë të ankuesit për pozitën e cekur si më lartë nuk është bërë për shkak se i njëjti me rastin e aplikimit nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi të përvojës së punës, rrjedhimisht nisur nga shqyrtimi i aplikacionit të ankuesit Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ka dorëzuar vetën Pasqyrën e llogarisë nga Trusti, mirëpo nuk ka dorëzuar asnjë dokument tjetër të përvojës së punës të lëshuar nga punëdhënësi.

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 2 nën

paragrafi 2.1, përcaktohet se: "2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1 të këtij neni, kandidatët, për t'u pranuar si nëpunës civilë, nëpunës të Shërbimit Publik dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës, duhet t'i plotësojnë edhe këto kërkesa: 2.1. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës", si rezultat i kësaj bazuar edhe në kriteret e konkursit dhe kërkesave për dokumentacionin që duhet dorëzuar, rrjedhë se kopja e dëshmisë së punësimit në procedurë të pranimit është kërkesë eksplicite për kandidatët, ngase kjo kërkohet edhe sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkangjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion", kështu që ankuesi nuk ka arritur që me prova materiale të dëshmojë atë që ka deklaruar në aplikacion respektivisht ndërlidhur me përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se dëshmia e pasqyrës së pagesave në fondin për kursime pensionale është dokument i pranueshëm dhe i cili vetëm e përforcon dëshminë e përvojës së punës, mirëpo pasqyra e pagesave në fondin për kursime pensionale nuk është dokument i cili pasqyron në mënyrë të detajuar pozitën që është duke e ushtruar pala, nga rrjedhë se ankuesi me rastin e aplikimit bashkërisht me dokumentin e pagesave në fondin e kursimeve pensionale është dashur të bashkëngjis edhe dëshminë e përvojës së punës konkretisht vërtetimin e përvojës së punës të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit e që është dokument primar, këtë e ka potencuar edhe Gjykata e Apelit e Kosovës sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmojnë me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/1-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale.

Nisur nga baza ligjore e përmendur si më lartë, dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, respektivisht dëshmitë e dërguar nga ankuesi me rastin e aplikimit, rrjedhë se ankuesi nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale përvojën e punës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me Nr.01/2023 i datës 07.06.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse i njëjti është nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, nga konstatimi si më lartë, thekson faktin se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, ankuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga e drejta për t'iu nënshtruar procedurave të tjerë të pranimit ngase obligimi për të dorëzuar dokumentacionin së bashku me aplikacionin është obligim i kandidatit e jo institucionit, ri rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit



konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuar për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.922/2023, datë 02.08.2023

Avdyl Bekteshi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

konstaton se të gjitha pretendimet e ankuesit janë të pabazuar për shkak që nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe faktike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.922/2023, datë 03.08.2023

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Mehdi Geci;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

